

## Fletë Faktesh

# Siguria e fëmijëve online

## Përse duhen rregullime ligjore?

### Studimi: Pornografi, të panjohur dhe tallje publike


Në dhjetor 2013 – janar 2014, 900 fëmijë të moshës 13 – 18 vjeçare, u intervistuan në Shqipëri nga World Vision, në lidhje me internetin. Kjo fletë faktesh paraqet pikërisht gjetjet kryesore të tij si dhe rekomandimet e nevojshme, përmes rishikimit ligjor të politikave të sigurisë së qëndrimit online të fëmijëve. Pyetsori u zhvillua në Tiranë, Korçë, Shkodër, Vlorë, Elbasan dhe Peshkopi. 67% e fëmijëve të intervistuar jetojnë në zonat rurale dhe 55% e tyre janë vajza. Studimi u krye nga World Vision Albania and Kosovo dhe Child Protection and Participation Learning Hub.



900 fëmijë të moshës  
13 – 18 vjeçare



85% e të rinjve të intervistuar  
kanë një kompjuter në shtëpi




67% e fëmijëve të intervistuar  
jetojnë në zonat rurale



## Gjetjet kryesore të këtij pyetësi janë:

Tri pajisjet më kryesore që përdoren nga fëmijët shqiptarë, që i përkasin moshës 13-18 vjeç, për të përdorur mediet ose për të luajtur online janë telefonat celularë (65%), kompjuterat personalë (PC-të) (59%), dhe laptop-ët (43%).

- Ndryshe nga vende të tjera europiane, familjet shqiptare parapëlqejnë që t'i mbajnë kompjuterat në dhomat e fëmijëve. Të dhënat tregojnë se 62% e fëmijëve që kanë akses në internet kanë një kompjuter në dhomën e tyre të gjumit.
- Kur u pyetën lidhur me perceptimet e tyre për rreziqet online, fëmijët shqiptarë ndanë të njëjtat opinione si ato të fëmijëve të vendeve të tjera europiane. Rreziqet më kryesore të perceptuara ishin ato të lidhura me përmbajtjen, pasuar nga ato të lidhura me sjelljen dhe më pas ato të lidhura me kontaktet.
- Ngacmimet (bullying), vjedhja e fjalëkalimeve, si dhe shikimi i paqëllimshëm i materialeve pornografike gjatë përdorimit të internetit janë çështje serioze me të cilat përballen fëmijët aktualisht, ku 45% e të pyeturve vunë në dukje se fëmijëve iu duhet të përballen me të tilla çështje çdo ditë.
- Sipas 44% të të pyeturve, fëmijët shohin materiale pornografike çdo ditë.
- 47% e fëmijëve të intervistuar pranojnë që, brenda vitit të fundit, ata janë kontaktuar online nga një individ i panjohur.
- Nga 47% e fëmijëve që janë kontaktuar online nga një individ në vitin e fundit, 40% e tyre ishin kontaktuar nga persona të huaj.
- Shumica e qytetarëve të huaj të panjohur që kontaktojnë fëmijët shqiptarë online janë nga Mbretëria e Bashkuar (33%), Italia (14%) dhe nga SHBA (8%).
- 68% e fëmijëve si nga zonat rurale ashtu edhe nga ato urbane konfirmojnë ekzistencën e vendndodhjeve, kompjuterave, ose ekraneve që shfaqin materiale pornografike në kundërshtim me dëshirën e tyre.
- Shumica e materialeve pornografike të paqëllimshme që shfaqen ndodh në qendra internet (internet café).
- 32% e fëmijëve të intervistuar konfirmuan që nëse do të lëndoheshin online, më pak të mundshmit për t'iu kërkuar ndihmë do të ishin mësuesit. Kjo pësohej nga policia, ku 27% e fëmijëve nuk e konsiderojnë si një institucion për ndihmë.



## Rekomandime nga Sondazhi

Institucionet arsimore, organizatat e shoqërisë civile, si dhe bizneset duhet të promovojnë rritjen e ndërgjegjësimit dhe të tjera praktika për sigurinë për fëmijë të vegjël dhe për adoleshentët.

Participation

1. Legjislacioni duhet të garantojë që qendrat e internetit ose internet kafetë të pajisen me hapësira vetëm për minorenët, në të cilën të bllokohet aksesimi për përmbajtje për të rritur.
2. Qeveria duhet të aktivizojë lundrim më të sigurtë në internet për fëmijët duke i caktuar çdo minoreni një emër përdoruesi dhe një fjalëkalim unik. Këto hollësi të caktuara hyrjeje do të ishin të detyrueshme për të hyrë në internet në vende publike. Kjo metodë do të kufizonte aksesin e minorenëve vetëm në përmbajtje që është e sigurt.
3. Qeveria duhet të forcojë dhe unifikojë, mekanizmat përgjegjës për grumbullimin dhe përgjigjen ndaj raportimeve të fëmijëve për abuzimet online. Ky mekanizëm raportimi duhet që të jetë eficient, i lehtë për t'u arritur, dhe miqësor ndaj fëmijëve nëpërmjet një platforme online etj.
4. Operatorët celularë duhet t'u ofrojnë prindërve mundësinë për të kërkuar kufizimin e aksesit online për fëmijët e tyre, të tillë që të lejojë vetëm përmbajtje që të jetë e sigurt.
5. Prindërit duhet të këshillohen që të flasin me fëmijën e tyre mbi internetin ose të ndajnë një aktivitet online bashkë me ta.
6. Me qëllim që të përballen me sfidat e ardhshme të sigurisë online për fëmijët, i duhet kushtuar vëmendje e posaçme trajnimit të përshtatshëm dhe përmirësimit të dijeve të prindërve. Edhe mësuesit kanë nevojë të trajnohen dhe të përfitojnë kualifikimet e duhura. Trajnimi duhet të shtrihet edhe në nivelin e kopshteve.
7. Përpjekjet për promovimin e përdorimit të internetit duhen shoqëruar nga nisma kundër ngacmimeve (bullying).

## Rekomandime lidhur me Politikëbërjen

1. Politikat e qeverisë gjithashtu duhet të marrin në konsideratë interesin e minorenëve; duhet të nxitet vetëndërgjegjësimi midis minorenëve.
2. Vënia në dispozicion e linjave telefonike të dedikuara (hotlines) nga Policia e Shtetit për sa i përket raportimit të abuzimit të minorenëve online.
3. Duhet të jetë kërkesë ligjore që ISP-të të instalojnë pajisje të posaçme të cilat mund të njoftojnë që përmbajtja e përcjellë është e jashtëligjshme dhe e dëmshme për minorenët në shërbimet e rrjetit që ofrojnë. Ekzistojnë software në treg që mund të monitorojnë përmbajtjen nëpërmjet përdorimit të fjalëve kyçe.
4. Duhet të jetë kërkesë ligjore që ISP-të të ofrojnë shërbime mbrojtëse (mjete kontrolli prindëror, filtra), ose falas ose me pagesë të vogël.
5. Nuk ekzistojnë shumë mjete të përshtatshme për pajisjet e lojrave, tabletet dhe telefonat celularë – pajisje që po përdoren gjithnjë e më shumë nga fëmijët për t'u futur online – dhe nuk ka zgjidhje për përdoruesit që aksesojnë përmbajtje në telefona celularë ose tablete duke përdorur një aplikacion dhe jo një browser (program për shfaqjen e skedarëve html që përdoren për të naviguar internetin).
6. Personeli i shkollave që jep lëndët e IT duhet të ketë kualifikimin e duhur dhe të trajnohet çdo vit nga MASH. Trajnimi duhet të shtrihet edhe tek personeli i kopshteve lidhur me rrezikun për pornografinë e fëmijëve në përgjithësi dhe për pornografinë e fëmijëve në internet në mënyrë më specifike.
7. Kurrikula e shkollave në lidhje me IT duhet të përditësohet rregullisht dhe të zgjerohet për të përfshirë mbrojtjen e fëmijëve në internet.
8. Fushatat e ndërgjegjësimit nuk duhet të kufizohen vetëm në "Ditën e internetit" dhe në shkolla pilot por duhet

të organizohet në programe të përhershme dhe afatgjata.

9. Njësitë e krimit kibernetik duhet të përfshijnë më shumë ekspertë IT dhe të kenë specialistët e vet të mjekësisë ligjore.
10. Gjykatat duhet të kenë gjyqtarë të posaçëm për t'u marrë me kundravajtjet e krimit kibernetik.
11. Ndërmjet të gjitha agjencive ligjzbatuese duhet të organizohet një memorandum bashkëpunimi.
12. Ligji duhet të përmirësohet për të lejuar policinë e shtetit dhe agjenci të tjera të zbatimit të ligjit për të kërkuar të dhëna nga ISP-të drejtpërdrejt dhe jo nëpërmjet AKEP<sup>1</sup>.
13. Autoriteti i AKEP duhet zgjeruar për të monitoruar dhe mbikqyrur Internet Café-të. Në kontratat midis ISP-ve dhe Internet Café-ve mund të shtohet një nen për ta specifikuar këtë autoritet, kur këto të fundit nuk janë regjistruar me AKEP.
14. Autoriteti i AKEP mund të përfshijë monitorimin e pikave të shitjeve të kompjuterave të përdorur nëse ato janë të certifikuara nga jashtë dhe nuk përmbajnë përmbajtje të jashtëligjshme. Gjithashtu, doganat nuk duhet të lejojnë tregtimin në Shqipëri të kompjuterave të përdorur që nuk përmbajnë një certifikatë pastërtie.

## Rekomandime lidhur me Legjislacionin

15. Ligji nr. 97/2013 "Për Median Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" sugjerohet të rishikohet. Në përkufizimin e "përmbajtje e dëmshme," mund të përfshihet përmbajtja e promovuar ose e lidhur me mallra dhe shërbime IT, të cilat mund të dëmtojnë fëmijët.
16. Ligji nr. 10128, datë 05/11/2009 "Për Tregtinë Elektronike" ka nevojë të rishikohet dhe të shprehet se çfarë veprimesh dhe politikash duhet të ndërmarrin Ofruesit e Shërbimeve të Shoqërisë së Informacionit (PISS) lidhur me mbrojtjen e fëmijëve në internet.
17. Ligji nr. 10347, datë 4.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve" duhet rishikuar dhe të ofrojë mbrojtje nga përdorimi i mundshëm i rrezikshëm i internetit.
18. Ligji nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për Mbrojtjen e Konsumatorëve," ndryshuar me Ligjin nr. 10444, datë 14.2011 ka nevojë të rishikohet. Kompanitë duhet të detyrohen të informojnë minorenët lidhur me rrezikun e mallrave dhe shërbimeve të tyre elektronike. Këto duhet të përfshijnë një nen lidhur me etiketimin e lojrave sipas moshës. Duhet të shtohen nene specifike për të ofruar mbrojtjen e fëmijëve që përdorin shërbimet e lojrave online. Sugjerohet që Ligji nr. 10347, datë 4.11.2010 "Për Mbrojtjen e Të Drejtave të Fëmijëve" të përfshijë mbrojtjen nga përdorimi i internetit dhe të gjitha efektet e tij anësore për minorenët.
19. Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" ndryshuar me Ligjin nr. 102/2012 duhet të mbulojë çështjet e përmbajtjes "së jashtëligjshme" dhe "të dëmshme." Gjithashtu, duhet të jetë më i qartë lidhur me mbrojtjen e fëmijëve në internet. Roli i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) duhet të jetë proaktiv lidhur me mbikqyrjen e shërbimeve të ISP-ve që mund të përmbajnë përmbajtje të jashtëligjshme. AKEP-it duhet t'i jepet më shumë pushtet për të rregulluar dhe mbikqyrur internet café-të dhe pikat e shitjes së kompjuterave të përdorur. Sugjerohet që legjislacioni për krimin kibernetik të rishikohet. Ai duhet të përmbajë një përkufizim për "Pornografinë e fëmijëve në internet." Po ashtu, ligji duhet të konsiderojë si kundravajtje veprimet që lehtësojnë pornografinë e fëmijëve në internet të tilla si "marrje e aksesit me dijeni," "miqësimi," "aktivizimi," "ndihma," "përkrahja," dhe "tentative" dhe "rrethanat përkeqësuese." Ligji për krimin kibernetik duhet të ofrojë mbrojtje për dikë që përballlet me akses në përmbajtje "të jashtëligjshme" dhe "të dëmshme" nëpërmjet internetit për qëllime jo-kriminale (dmth, shkencore dhe akademike).
20. Legjislacioni shqiptar për krimin kibernetik duhet të përfshijë edhe ngacmimin seksual kundër minorenëve nëpërmjet përdorimit të internetit. Kodi i Procedurës Penale duhet të amendohet për arsye se nenet e lidhura me mbledhjen e të dhënave janë të mjegullta.

1 Autoriteti për Komunikimet Elektronike dhe Postare